


PARIMET E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

TË DHËNAT PERSONALE DUHET TË PËRPUNOHEN NË MËNYRË TË DREJTË DHË TË LIGJSHME

Çfarë nënkuptohet me përpunim të drejtë?

Përpunimi i të dhënave personale duhet mbi të gjitha të jetë i drejtë, si dhe të plotësojë kushtet përkatëse për përpunim. "Përpunimi" përgjithësisht nënkupton grumbullimin, përdorimin, zbulimin, mbajtjen, ndreqjen, fshirjen, transmetimin, transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale, si dhe shkatërrimin e tyre, dhe nëse ka ndonjë aspekt të përpunimit që është i padrejtë, do të ketë një shkelje të



parimit të parë të mbrojtjes së të dhënave edhe në qoftë se ju mund të tregoni që keni plotësuar një ose më shumë nga kushtet për përpunim.

Përpunimi i drejtë në përgjithësi kërkon nga ju që të jeni transparent, të qartë dhe të hapur me individët se si do të përdoren informacionet e tyre. Transparenca është gjithmonë e rëndësishme, por sidomos në situata ku individët kanë një zgjedhje nëse ata dëshirojnë të hyjnë në një marrëdhënie me ju.

Vlerësimi nëse informacioni është duke u përpunuar në mënyrë të drejtë varet pjesërisht nga mënyra se si është marrë.

Në veçanti, nëse dikush është mashtruar kur është marrë informacioni, atëherë kjo tregon që përpunimi nuk mund të jetë i drejtë.

Ligi "Për mbrojtjen e të dhënave personale" thotë se informacioni duhet të trajtohet si i marrë në mënyrë të drejtë, në qoftë se ai është siguruar nga një person i cili është i autorizuar ligjërisht për ta siguruar atë.



TË DHËNAT PERSONALE DUHET TË GRUMBULLOHEN PËR QËLLIME SPECIFIKE DHE TË LIGJSHME. TË DHËNAT NUK DUHET TË PËRPUNOHEN MË TEJ APO NË NDONJË MËNYRË TË PAPAJTUESHME ME KËTO QËLLIME.

Kjo kërkesë ka për qëllim të sigurojë që kontrolluesit të jenë të hapur në lidhje me qëllimet për mbledhjen e të dhënave personale dhe se përdorimi i informacionit është në përputhje me këto qëllime.

Në praktikë, për mbrojtjen e parimeve të të dhënave do të thotë se ju duhet:

- të jeni të qartë që nga fillimi se pse i keni mbledhur të dhënat personale dhe atë që keni ndërmend të bëni me to;



- të jeni në përputhje me atë që thotë ligji, aktet nënligjore dhe aktet administrative të Komisionerit për njoftimin dhe regjistrimin pranë Zyrës së Komisionerit;
- të realizohet mbledhja dhe përpunimi i të dhënave vetëm sipas njoftimit të regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Kontrolluese; dhe
- të njoftoni Zyrën e Komisionerit për çdo ndryshim në qëllimin apo qëllimet e përpunimit dhe në përmbajtjen e njoftimit të mëparshëm, si dhe nëse keni vendosur të realizoni një përpunim të ri të të dhënave personale.



TË DHËNAT PERSONALE DUHET TË JENË TË SAKTA DHE KUR ËSHTË E NEVOJSHME TË PËRDITËSOHEN

Ligji ka dispozitë të veçantë në lidhje me saktësinë e informatave që individët sigurojnë për veten e tyre, ose që japin për palët e treta. Në përputhje me këto dispozita duhet të:

- ndërmerrni hapa të arsyeshëm për të siguruar saktësinë e ndonjë të dhëne personale që ju merrni;
- siguroni se burimi i të dhënave personale është i qartë;
- shqyrtoni me kujdes çdo sfidë për saktësinë e informacionit, dhe
- shqyrtoni nëse është e nevojshme për të përditësuar informacionin.

Për shembull, nëse një individ ka ndryshuar vendbanimin nga Durrësi në Tiranë, një regjistrim që tregon se ai aktualisht jeton në Durrës është padyshim i pasaktë. Por, një regjistrim që tregon se ai dikur ka jetuar në Durrës mbetet i saktë edhe pse ai nuk jeton më aty. Ju duhet të jeni gjithmonë të qartë për atë që një regjistrim ka si qëllim për të treguar.

A duhet të përditësohet informacioni mbi të dhënat personale?

Kjo varet nga ajo për çfarë është përdorur informacioni. Nëse informacioni është përdorur për një qëllim që të mbajë të dhënat aktuale ai duhet të përditësohet.

Gjithashtu, kur informacioni është mbajtur vetëm për arsye shkencore, statistikore, historike apo të tjera, përditësimi i informacionit mund edhe të humbasë qëllimin e mbajtjes së tij.




**Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Rr. e Kavajës, Nd 80, H.1, Tiranë

+355 4 22237200

info@idp.al; www.idp.al



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**